

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reforma territoriale: 3,500 qytetarë u dëgjuan, Mazniku: Bashki më të forta, shërbime më cilësore dhe m ë shumë mundësi nga fondet e BE-së
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/reforma-territoriale-3500-qytetare-u-degjuan-mazniku- bashki-me-te-forta--i587888
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:57:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 11:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2064b8c17a362fe43aa3b081df9b0f98145c40fd1bdde2769f406a4c618110c2
TEKSTI	02068009a3e5737df3c3e5d456cabd459fe2946541a55d32f1188057b310d671
PAMJA	e845275e0f332e6f8102aea70857b235c69300fc52d6a7bf30933ac2c1dc705b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e3f61b0413a31629d25d5d70460bdab07bd954dda5672af4d0f3de146ae1de75
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/e3f61b0413a31629d25d5d70460bdab07bd954dda5672af4d0f3de146ae1de75

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



Ne kerkim per trahk nderkombetar kokaine, arrestohet ne Rusi Shpetim AliuZelensky tlet ne OKB: Moska ka pesuar humbje poshteruese! Vetem nje njeri deshiron lufte fundit

Reforma territoriale: 3,500 qytetarë u dëgjuan, Mazniku: Bashki më të forta, shërbime më cilësore dhe më shumë mundësi nga fondet e BE-së



23 Shtator 2026, 13:41Kronika TEMA



Reforma administrativo-territoriale dhe ndikimi i saj në ofrimin e shërbimeve për qytetarët ishin në fokus të prezantimit të bashkëkryetarit të Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale, Arban Mazniku, në Komisionin për Çështjet Ligjore.

Mazniku e cilësoi reformën një çështje që prek drejtpërdrejt jetën e përditshme të qytetarëve, duke nisur nga pastrimi, ndriçimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, deri te shërbimet në shkolla dhe furnizimi me ujë.

Gjatë prezantimit, ai solli në vëmendje punën e zhvilluar për rreth nëntë muaj nga Komisioni i Posaçëm, i cili u ngrit me përfaqësim të barabartë mes mazhorancës dhe opozitës, por me përpjekjet e vazhdueshme të opozitës për të penguar dhe bllokuar punën e komisionit. Sipas Maznikut, Komisioni zhvilloi 23 mbledhje dhe seanca dëgjimore, ndërsa në konsultimet publike në 11 qarqe morën pjesë mbi 3,500 qytetarë. Në proces u administruan gjithashtu 88 kërkesa, peticione dhe propozime.

“Për sa i përket procesit, siç jeni në dijeni, është krijuar Komisioni i Posaçëm nga Parlamenti. Ai është krijuar me dakordësinë e mazhorancës, me paritet midis mazhorancës dhe opozitës, me tetë anëtarë secili dhe me dy bashkëkryetarë. Pati një mandat prej nëntë muajsh ose dyqind e shtatëdhjetë e tre ditësh. Zhvilloi njëzet e tre mbledhje dhe seanca dëgjimore. Në këto u dëgjuan tre mijë e pesëqind plus qytetarë, të cilët morën pjesë në seanca në njëmbëdhjetë qarqe. U zhvilluan njëmbëdhjetë dëgjesa publike nga periudha 22 prill deri më 25 qershor. Pesëdhjetë e gjashtë bashki u referuan në dëgjesat e qarqeve, pesë seanca dëgjimore në Kuvend me kryetarët e bashkive dhe gjithashtu janë administruar tetëdhjetë e tetë kërkesa, peticione, propozime nga Komisioni, përfshirë këtu katërmëdhjetë kërkesa, peticione për rend së pari të Kuvendit dhe opinione në platformë elektronike. Kjo është një përmbledhje e përgjithshme. Do të flas pak për mbledhjet e Komisionit, sepse ka disa elementë të rëndësishëm që na çojnë të kuptojmë pak më shumë mbi procesin. Kuvendi e krijoi Komisionin me një vendim të datës 27 tetor të vitit 2005, vendimi shtatëdhjetë e pesë. Më datën 30 tetor, vetëm tre ditë më pas, mazhoranca emëroi tetë anëtarët e saj. Opozita i emëroi anëtarët e saj më 6 nëntor, pra pesëmbëdhjetë ditë pas krijimit të Komisionit solli emrat e anëtarëve. Më datën 11 nëntor, vetëm katër ditë pas saj, u thirr mbledhja e parë e konstituimit të Komisionit, në të cilën opozita nuk erdhi. Gjashtë anëtarë të Partisë Demokratike nuk morën pjesë. Më pas, vetëm më 27 nëntor u realizua takimi i parë, ku u diskutua për kalendarin e punës, numrin e ekspertëve dhe sekretariatit. Nga ai moment opozita nuk mori pjesë në mënyrë sistematike për pothuajse tre muaj në Komision. Më 22 janar mbledhja nuk u zhvillua sepse mungoi kuorumi. Më datën 2 shkurt mbledhja nuk u zhvillua sepse

mungoi koalicioni dhe vetem me 11 shkurt, pasi u propozua nga ana e anetareve te Partise Socialiste ne seance plenare kerkesa per ngrysimin e perberjes se strukturës së Komisionit, opozita vendosi të marrë pjesë. Është e rëndësishme të theksoj këtu që nëntëdhjetë e shtatë ditë kaluan nga mbledhja e parë deri te mbledhja ku u miratua kalendari, ose njëqind e dymbëdhjetë ditë, për të qenë saktë, nga dita që u themelua me vendim të Kuvendit. Deri në mbledhjen e kalendarit kaluan njëqind e dymbëdhjetë ditë, ose dyzet e një për qind e kohës që iu hëngër Komisionit nga mungesa sistematike e opozitës. Më 11 shkurt u vendosën sekretari dhe emrat e ekspertëve. Më datën 16 shkurt u miratua kalendari dhe më pas kalendari i detajuar i takimeve vendore u miratua më 1 mars. Më 25 mars filloi faza e parë e konsultimeve dhe më 15 korrik u bë mbledhja e prezantimit të raportit, në të cilën nuk ia dolëm dot që të prezantonim raportin, as nga njëra palë, as nga pala tjetër, sepse opozita nuk ra dakord të miratojë rendin e ditës dhe, për rrjedhojë, mbledhja nuk u bë dot. Ndërkohë, gjithashtu janë bërë një seri dëgjësash si Komision: më datën 7 prill me ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, zotin Demo; më datën 13 maj është dëgjesa me Elbasan-Kukës-Durrës; më 20 maj me Gjirokastrë-Lezhë-Korçë; më 28 maj Berat-Fier-Shkodër dhe më 3 qershor Dibër-Vlorë dhe Tiranë, e cila nuk u zhvillua për mungesë të anëtarëve. Pjesa e dytë për të cilën është e rëndësishme të flasim janë dëgjimet publike. Janë zhvilluar dëgjimet publike në njëmbëdhjetë bashki, ku kanë qenë anëtarë të Komisionit nga ana e mazhorancës dhe opozitës, në njëmbëdhjetë qarqe, dhe tre mijë e pesëqind qytetarë. Është e rëndësishme të thuhet që në këtë moment ishim përpara një vendimi kyç: ose Komisioni të mbyllte funksionin e tij pa asnjë produkt, çka në fakt ishte puna për sa kohë që e kishim dakordësuar një Komision me paritet dhe me bashkëkryesi. Për fat të keq, ai ishte produkti i Komisionit. Pra, Komisioni është mbyllur pa produkt.

Por ne, një grup deputetësh socialistë, anëtarë të Komisionit, në respekt të punës që u bë, në respekt të punës së ekspertëve dhe rëndësisë që kjo çështje ka, ishim përpara dy zgjedhjesh. Njëra ishte që kjo punë të mos shkonte e gjitha dëm dhe tjetra ishte që të bënim në këtë moment një propozim specifikisht për pjesën e reformës territoriale, ndarjes së hartës, e cila lidhej ngushtësisht edhe me elementet e ciklit elektoral. Pjesa e dytë, për tre elementët e tjerë që kanë të bëjnë me funksionet dhe shërbimet, me financat vendore dhe rajonet, ishte që të merrnim një vit tjetër kohë për të punuar si Parlament, bashkë me qeverinë, për të detajuar në mënyrë specifike funksionet bashkiake, financat vendore dhe rajonet”, tha ai.

Një pjesë e rëndësishme e prezantimit iu kushtua gjetjeve të raportit të ekspertëve dhe rezultateve të reformës së vitit 2014. Mazniku theksoi se Shqipëria kaloi nga 373 njësi vendore në 61 bashki, duke e cilësuar këtë një konsolidim prej 84 për qind.

Sipas të dhënave të paraqitura prej tij, të ardhurat vendore për banorë janë rritur nga 2,684 në 13,292 lekë, ndërsa detyrimet e prapambetura janë ulur me 76 për qind. Shpenzimet vendore janë rritur nga 34 miliardë në 92 miliardë lekë, ndërsa të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë rritur nga 11 në 40 miliardë lekë.

“Një pjesë e madhe, ose pjesa më e madhe e elementëve që lidhen me jetën e përditshme të qytetarëve, në fakt lidhen me pushtetin vendor”, tha Mazniku, duke nënvizuar se çdo ndryshim në mënyrën e organizimit të pushtetit vendor duhet të lidhet me objektivin për shërbime më të mira për qytetarët.

Në vijim të prezantimit, Mazniku shpjegoi edhe rrugëtimin e propozuar për reformën. Sipas tij, puna e Komisionit dhe e ekspertëve ka evidentuar nevojën për të trajtuar në mënyrë të veçantë hartën territoriale, ndërsa për funksionet dhe shërbimet, financat vendore dhe rajonet propozohet vijimi i punës për një periudhë tjetër, me qëllim detajimin e tyre.

Mazniku argumentoi se reforma duhet të shihet edhe në funksion të procesit të integritetit europian dhe të mundësisë që Shqipëria të përfitojë më shumë nga instrumentet dhe fondet që lidhen me këtë proces.

“Jo e nisur nga politika, jo e nisur nga qëllimet politike, por te tentativa për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët dhe për të përfutur maksimumin e mundshëm si Shqipëri nga hapat e integritetit europian”, u shpreh ai.

3 Komente

G

Gojorsat e edvinit

23 Shtator 2026, 14:09

Pershendetje te dashur lexues socialist. Ju qifsha farefis e ca keni. Ju shkerdhefsa ca ju mban pragu. Rrespekt s.b.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 2 🗳️ 0 ❤️ 0

B

bimi

23 Shtator 2026, 14:20

Kur u degjuan keta 3500 mo se nuk i kemi pare!!!! Keni degju njani tjetrin

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 0

D

Detari

23 Shtator 2026, 15:04

hahahahahahah numrat pak keni vene

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Vlora Hyseni në arrest shtëpie, Elvis Lila merr përkohësisht drejtimin e SHISH-it](#)

13:35 Kronika / 28 komente

[Dokumenti - Vlora Hyseni ishte propozuar në gusht nga Franca për gradën "Kalorës" të Urdhrit Kombëtar të Meritës](#)

12:38 Kronika / 40 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.